



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 57/prot.
1

Tiranë, më 01.03.2023

VENDIM

Nr. 10, datë 01.032023

“Për ngritjen e njësisë kërkimore afatshkurtër në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive”

Bazuar në ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, neni 12, pika 2, neni 19, Statutin e ASH-së neni 31, pika 7, neni 44 dhe 45, mbështetur në shkresën e kryetarit të Seksionit të shkencave natyrore dhe teknike nr. 57 prot., datë 25.01.2023 (bashkëngjitur), Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në mbledhjen e saj të datës . .2023,

VENDOSI:

1. Të ngrëjë pranë Akademisë së Shkencave njësinë e përkohshme të kërkim-studimit në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive.
2. Njësia do të ketë si objekt nxitjen dhe koordinimin në studime, projekte dhe aktivitete shkencore të nivelit të lartë me rëndësi apo të tjera që trajtohen për herë të parë, në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive me fokus kryesor rrezikun natyror/gjeologjik dhe risqet përkatëse në shkallë kombëtare.
3. Njësia përbëhet nga:
 - a) Rrapo Ormeni, Akademia e Shkencave të Shqipërisë;
 - b) Naser Peci, Fkulteti i Gjeoshkencave, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, Kosovë;
 - c) Viktor Doda, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
 - ç) Ismail Hoxha, Instituti i Gjeoshkencave IGJEO, Universiteti Politeknik i Tiranës;
 - d) Altin Karriqi, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës;
 - dh) Markel Baballeku, Fakulteti i Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
4. Kohëzgjatja e veprimtarisë është deri në 2 vjet.

5. Akademia e Shkencave siguron mbështetjen logjistike dhe mbulon shpenzimet financiare për veprimtarinë e njësisë.
6. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi kryetari i seksionit të shkencave natyrore dhe teknike, sekretari shkencor dhe kancelari.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

Skënder Gjinushi
KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 264 / Prot.

Tiranë, më 14 04 / 2023

Vendim nr. 15 datë 14 04 .2023

“Për një shtesë në vendimin nr. 10 datë 1.3.2023 “Për krijimin e njësisë kërkimore të përkohshme në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive”

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, neneve 44 dhe 45 të Statutit, referuar kërkesës së bordit drejtues të “Njësisë kërkimore të përkohshme në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive” me nr. prot. 264 datë 30.03.2023, Kryesia e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e saj të datës _____.____.2023,

VENDOSI:

- Në drejtimin e njësisë të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive caktohen:
 - Akad.asoc. Rrapo Ormeni, drejtues.
 - Prof.Dr. Naser Peci, zëvendës drejtues.
- Koordinatorë e kësaj njësie caktohet Dr. Albana Hasimi.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: kryetari i Seksionit të shkencave natyrore e teknike, sekretari shkencor dhe kancelari.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR